

KONTRATE THEMELIMI



I SHOQERISE PRIVATE " NDERTIM DHE TREGETIM " SH.P.K. " SPEKTRI "

ME SIGLEN R Y FIER

Sot më dt. 16.1.1995 bashkëortakët themelues të shoqerisë private " Ndërtim dhe tregëtim " Sh.p.k. " SPEKTRI " me siglën R Y në Fier.

1. Robert Yzeiri, i biri i Qemalit, lindur më 1966 në Fier dhe banues po në Fier, Inxhinier ndërtimi (dega hidroteknike).

2. Ismet Yzeiri, i biri i Qemalit, lindur më 1960 në Fier dhe banues në Fier. Rr" Dervish Hekali Pl.22 ,A .4

Që të dy madhorë, me sotësi të plotë juridike e përtë vepruar me vallnetin e tyre të lirë e të plotë ranë dëkort të krijojnë shoqerinë private " Ndërtim dhe tregëtim" Sh.p.k. " SPEKTRI " R Y Fier dhe hartuan këtë kontratë themelimi me kuehtet e mëposhtëme :

1. Ndërtim dhe shitje të banesave qytetare, objekte industriale, social kulturore, bujqësore, turistike, hoteliere, ujësjellësa, punime restauruese, punime të dheut, muraturë, punime betoni e barme të zakonehme, punimet e shëmbjes, kompletimi me instalime të brendshme të objekteve të ndërtuara, marrjen dhe dhënien me qira të pajisjeve të ndërtimit, të mjetëve të transportit për ndërtim dhe tregëtim i tyre.

2. Qendra e shoqerisë private sajtë qyteti i Fierit.

3. Drejtimi i administrativ të shoqerisë do ta bëjë Administrator i saj z. Robert Yzeiri. Gjithashtu ai do të ndjekë dhe mardheniet kontaktore me Bankën.

4. Kapitali themelor i shoqerisë sajtë në mjetë monetare: 1.000.000 leks të cilat derdhen në Bankën Tregëtare,

Degu amfiteatrit nga të cilat 85 % administrator i shoqërisë Robert Yzeiri, 15 % Ismet Yzeiri.

5. Fitimi i realizuar nga shoqeria do të shpërndahet, 80 % Robert Yzeiri, 20 % Ismet Yzeiri.

6. E gjithë veprimtaria e shoqërisë në fushën e ndërtimit dhe tregëtimit do ti përbëhet kërkesave të legjislacionit shqipëtar dhe akteve nënligjore që dalin në zbatim të tij.

7. Mosmarrëveshjet ndërmjet ortakëve do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve dhe mirëkuptimit të ndërsjellës të tyre dhe kur nuk arrihet të gjenden zgjidhje e sejçila palë ka të drejtë të drejtohet Gjykatës së Rrethit.

**ORTAKËT THEMELUES**

1. Robert Yzeiri

2. Ismet Yzeiri

Tiranë, më 16.1.1995



## S T A T U T I

I SHOQERISE PRIVATE " NDERTIM DHE TREGETIM " SH.P.K. " SPEKTRI "

ME SIGEL R Y FIER

### Neni 1

Shoqeria është krijuar dhe do të shvillojë aktivitetin e saj në përputhje me ligjin NR. 7638 dt. 19.11.1992 " PER SHOQERITË TREGETARE ". Ajo do të veprojë kryesisht në rrithin e Fierit, por në basë të kërkesës dhe ofertës edhe në qytetet e tjera të vendit. Selinë dhe vendqëndrimin e vet qhgëria e ka në qytetin e Fierit.

### Neni 2

Shqëria kryesisht objektet i ndërtton veta, por ajo bashkëpunon gjerësisht me partnerët të vendit dhe të huaj, me përgjegjësi të kufizuar.

### Neni 3


Shqëria është krijuar për një kohë zgjatje mbi 10 vjet.

### Neni 4

Personalitetin e vet juridik, shoqeria e fiton me tu rregjistrouar në rregjistrin tregtar të gjykatës së rrëthit Tirana, ndërsa aktivitetin e saj ndërtues e tregtar e fiton me tu rregjistrouar në Zyrën e Takës- Tatimeve të rrëthit Fier.

### Neni 5

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është : ndërtimi dhe tregëtimi i objekteve me karakter qytetar, industrial, turistik, bujqësor, hotelier, ujësjellësave, punimeve resteauruese, punimet e dhet, muraturat, punimet e betonit, beton arme të zakonshëm, punimet e shëmbjes, kompletimi i instalimeve të brendshme në



 e ndërtuara, tregëtimin e materialeve të gatshme për ndërtim, mardhëniet qiramarrëse dhe dhënëse për pajisjet e ndërtimit, të mjeteve të transportit për ndërtimit, të armaturave prej hekuri dhe druri.

#### Neni 6

Të gjithë veprimtarinë e saj ndërtueseë dhe tregetare shqipëria e zhvillon në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe aktet nënligjore që dalin për mbatimin e tij.

#### Neni 7

Kapitali themelor i shoqërisë është në mjetë momentare 100.000 lekë nga të cilat 85 % administratori shoqëria dhe 15 % ortaku Ismet Yzeiri.

Fitimi i realizuar nga shoqëria do të shpërndahet 80 % Robert Yzeiri dhe 20 % Ismet Yzeiri, pasi të zbriten fondet e parashikuara për rritjen e veprimtarisë së shoqërisë.

#### Neni 8

Për projektimin dhe ndërtimin e objekteve të veganta, shoqëria bashkëpunon dhe koperon edhe me shoqëritë ndërtimore e projektuesë të vendit dhe të huaja që zhvillojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë, ka leverdi dhe janë me përgjegjësi të kufizuar. Por pavarësisht nga bashkëpunimi dhe koperimi me të tretët, shoqëria përgjigjet vetsë për objektin, cilësinë e punimeve të kryera, afatet e ndërtimit, cilësinë e pajisjeve të brendëshme dhe dorëzimin në afatin e kontraktuar të objektit.

#### Neni 9

Shoqëria pranon porosi : për ndërtime të objekteve qytetare, turistike, bujqësore, industriale, për kryerjen e kanalizimeve, të ujësjellësave dhe punime të çfarëdollojshme gjermimi.

 të qdo lloji pajisje të ambienteve të brëndëshme, të ambienteve hidro-sanitare, të drizareve e dyerive të brendëshme e të jashtme, sipas shijes e kërkesës së klimatitve të saj, porosi të cilat janë të pakthyeshme.

Gjithashtu shoqëria merr pjesë në ankandet publike të ndërtimit dhe pranon oferta për ndërtimin e objekteve me fondet publike, fondet e shoqërive bamirëse, fondacioneve të ndryshme të vendit dhe të huaja që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri si dhe në ofertat e ndërtimit që bëjnë personat fizikë e juridikë shqiptar e të huaj.

Në çdo rast konkret, për çdo ofertë për të cilat arrihet në marrëveshje, shoqëria harton me palët porositëse kontratat përkatëse duke i detajuar detyrat e saj, detyrat e palës (palëve) kontraktuese, projektet e agjedhura, afatet e realizimit të veprës, mënyrën e financimit dhe afatin e dorëzimit të saj.

Para dorëzimit të objektit bëhet kolaudimi i tij në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe dorësimi me proces - verbal të rregullt. Pas këtij momenti shoqëria ndertuese i kalon të drejtën e pronësisë mbi objektin palës private.

#### Neni 10

Pjesëmarrja në ankandet dhe ofertat publike të ndërtimit, të pajisjeve të makinerive të ndërtimit dhe të orendive të objekteve ndërtimore, shoqëria e mbështet në levardinë ekonomike, iniciativën e lirë dhe në bashkëpunim me kooperimin e shoqërive të vendit dhe të huaja.

#### Neni 11

Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë e të kooperojë



4.

me përfundimisht edhe për shitjen, dhënien me qara të materialeve të ndërtimit, të makinerive të ndërtimit e të transportit për ndërtim, të projekteve e të pajisjeve për objektet ndërtimore deri në dorësimin e objektit me çelës në dorë, në afatet e përcaktuara në kontratën e porositësit.

Neni 12

Shoqëria ka të drejtë të nxjerrë, të prodhojë e të tregëtojë materiale inerte, parafabrikate, soleta për objektet ndërtimore të të tretëve, të pajisjeve për objektet e përfunduara deri në mobilizimin e bapesave sipas porosisë të klientëve të saj.

Neni 13

Për objektet e fituara në ankandet dhe ofertat publike për ndërtim, shoqëria fillimisht merr 30 - 40 % të vlerës së preventivit dhe mandej punimet shlyhen me situacionet mujore të punimeve të kryera deri në shlyerjen e plotë të objektit të kontraktuar.

Neni 14

Për objektet e ndërtimit me porosi, shoqëria merr 30% të vlerës së objektit sipas preventivit dhe mandej punimet e kryera shlyhen me situacionet mujore deri në përfundimin e plotë të objektit të porositur.

Neni 15

Financimi i shoqërisë për objektet e fituara në ankandet publike dhe ato me porosi bëhet në bazë të kontratës së porosisë nëpërmjet Bankës Tregtare të rrëthit ku palët kontratuase duhet të kenë çelur llogaritë rrjedhëse. Palët e interesuara kanë të drejtë të përdorin çdo Bankë, me kusht që të kemi

~~celon~~ ligarintë rrjedhëse dhe të kës gjendje financiare përvlerën e parashikuar në preventivin e objektit të zgjedhur përtësuar.

#### Neni 16

Për ndërtimet me porosi, shoqëria kontratuase me të interesuarin sipas projektit të zgjedhur, madhësise së tij, koston e sipas përllogaritjeve që shoqeron objektin dhe manualeve të preventivave, me qëmimet korente afatet ndertimore, afatet e dorëzimit të objektit, llojin e pajisjeve e të mobiljeve me çelës në dore.

#### Neni 17

Për kryerjen e veprimtarisë së saj ndertuese është tregetare shoqëria punëson personelin inxhiniero-teknik, ekonomistë, juristë e punëtorë dhe personel administrativ me kontratë të përkohëshme ose të përherëshme në përputhje me legjisacionin e punës në fuqi, por gjithmonë me atëstim profesional.

#### Neni 18

Për gjithë veprimtarinë e saj ndertimore, ekonomike e tregtare, shoqëria mban kontabilitet në përputhje me legjisacionin në fuqi. Në përputhje me fikimet e realizuara ajo derdh tatim-fitimin në Zyrën e Tatimeve të rrethit.

#### Neni 19

Në rradhë të parë fitimet shoqëria i përdor për :

- Shtimin dhe përmirësimin rrënjosor të bazës materiale-teknike për veprimtarinë e saj projektuese e ndertuese.
- Stimulimin e punës së të punësuarve në shoqëri.
- Krijimin e fondit rezervë, të fondit të sigurimeve shoqërore dhe të asjetencës sociale.

 - Për përmirësimin e kushtave të punës e të prodhimit.

Neni 20

Transaksionet ekonomiko - financiare bënë gjithmonë me anë të Bankës ku shoqëria ka llogarinë e saj rrjetësore, gjithmonë kundrejt mandat pagesës (arkëtimit). Shoqëria ka të drejtë të çelë llogari në valutë të huaj edhe në një Bankë të huaj në përputhje me rregullat e Bankës së Shtetit Shqiptar dhe të vendit ku ndodhet Banka e huaj. Gjithmonë firma e parë për transaksionet bankare është firma e administratorit të shoqërisë.

Neni 21

Vëprimtaria e shoqërisë organizohet, drejtohet dhe kontrollohet nga presidenti i saj. Ajo për probleme të vecanta mund të aktivizojë edhe specialistët të jashtëm në fusha të veganta.

Administratori i Shoqërisë ka këto të drejta :

- Organizon dhe drejton vëprimtarinë ekonomike financiare të shoqërisë dhe raporton për këtë në këshillin e ortakëve dhe në këshillin administrativ.
- Propozon Këshillit të ortakëve përbërjen e Këshillit administrativ të shoqërisë, që është organi i drejtimit operativ të vëprimtarisë së shoqërisë.
- Përfaqëson shoqërinë me të tretët, përparrë shtetit dhe gjykatave.

Administratori është firma e parë për të gjithë vëprimtarinë financiare të shoqërisë. Të gjitha dokumentat e saj dalin me firmën e tij dhe kanë fuqi drejtuese për të gjithë të punësuarit në shoqëri.



Neni 22

Këshilli i ortakëve është organi më i lartë urdhëshëm i shoqërisë. Ai mblidhet pës herë në gjashtë muaj ose një herë në vit dhe përoakton e miraton Statutin e Shoqërisë, miraton programin e zhvillimit të shoqërisë, strukturën organizative të saj, pagën e të punësuarve në qhoqëri dhe stimujt nxitës, miraton krijimin e filialeve dhe këshillin e kontroll revisionit të veprimtarisë ekonomiko - financiare të shoqërisë.

Neni 23

Këshilli administrativ është organi i drejtimit operativ të të gjithë veprimtarisë së shoqërisë. Ai përbëhet nga specialistë të fushave të ndryshme të punësuar në shoqëri. Ai drejtohet nga administrator<sup>1</sup> Shoqërisë dhe luan rolin e organit këshillmor të shoqërisë.

Neni 24

Mbyllja e veprimtarisë së shoqërisë bëhet me vendim të arsyetuar të presidentit të saj ose me propozimin e Këshillit të ortakëve. Në këtë rast, qdo ortak ka të drejtën e parablerjes së pjesëve të ortakëve të tjera, të përqëndrimit të kapitalit themelor në një dorë dhe vashdimin e veprimtarisë së shoqërisë, duke bërë ndryshimet në ditën e themelimit.

Në rast ndërprerje të veprimtarisë së shoqërisë, në rradhë të parë ejo shlyen detyrimet ndaj kreditorëve, klientëve dhe porositësve. Në rast falimentimi të saj, zbatohet ligji "Për falimentimin e shoqërive private".

## ORTAKËT

1. Robert Yzeiri

2. Iemet Yzeiri

ADMINISTRATORI

Robert Yzeiri